



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Bali Muharremaj , Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuçi , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	<i>PER</i> Elbert Krasniqi , Ministër i MAPL-së Jeton Qela , Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erblin Hetemi , Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL	Data: 17.04.2025 VI-020-193/1
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj , Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim	
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Suharekës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim 01 Nr. 016-18942 jepet pëlqimi për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 (nëntëdhjetenëntë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës

I miratuar më datë: 28.03.2025

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.04.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025, ka miratuar Vendimin 01 Nr. 016-18942 jepet pëlqimi për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 (nëntëdhjetenëntë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Suharekës është në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2022 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, përkatësisht me paragrafin 4 të nenit 6 të Rregullore (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, sipas të cilit:

“Pronat e paluajtshme të komunës që nuk janë në listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues si dhe nuk kanë miratim paraprak nga Kuvendi i Komunës nuk mund të jepen në shfrytëzim”.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Suharekës duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Bali Muharremaj , gradonačelnik opštine Suva Reka Bexhet Kuçi , predsedavajući Skupštine opštine Suva Reka
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko: <i>FA?</i>	Elbert Krasniqi ministar MALS-a Jeton Qela , v.d. generalnog sekretara MALS-a,
Od:	Erblin Hetemi , direktor Pravnog odeljenja MALS-a
Službenik-ca za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa , rukovodilac Odseka za monitorisanje opština
Službeni-ca za izradu pravne procene:	Vjosa Ahmetaj , viša službenica za monitorisanje opština
Predmet:	Zahtev za reviziju akta
Vrsta odluke:	Odluka Skupštine opštine Suva Reka

Dana,
17.04.2025.
br.VI-020-
193/1

Poštovani gradonačleniče,

Poštovani predsedavajući,

U skladu sa članom 9, Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju akata opština, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi sledeći opštinski akt:

Odluka 01 br. 016-18942 za davanje saglasnosti za razvijanje postupaka putem otvorenog konkurisanja za davanje na dugoročno korišćenje do devedeset i devet (99) godina nepokretnu imovinu opštine
Usvojena dana, 28.03.2025.
Podnošena na razmatranje u MALS-u dana, 01.04.2025.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je akt opštine u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Suva Reka, na sednici održanoj dana, 28.03.2025. godine, usvojila Odluku 01 br. 016-18942 za davanje saglasnosti za razvijanje postupaka putem otvorenog konkurisanja za davanje na dugoročno korišćenje do devedeset i devet (99) godina nepokretnu imovinu opštine

MALS, konstatuje da je odluka koju je donela Skupština opštine Suva Reka u suprotnosti sa Zakonom br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine i Uredbom (VRK) br. 09/2022 o utvrđivanju procedure za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine u skladu sa stavom 4, člana 6, Uredbe VRK br. 09/2020 o utvrđivanju postupka za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, po kome:

„Ne mogu se koristiti nepokretne imovine opštine koje se ne nalaze na posebnom spisku imovine predviđenih za korišćenje za narednu godinu i nemaju prethodno odobrenje Skupštine opštine.

Stoga, na osnovu gore navedenih, Skupština opštine Suva Reka treba preduzeti konkretne mere i u zakonskom roku od trideset 30 dana vrši reviziju i usklađuje akt sa zakonodavstvom na snazi.

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2 lidhur me nenin 14, paragrafi 1, dhe 3, të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019", e konform nenit 5, paragrafi 1, pika 1.3, lidhur me nenin 6 paragrafi 3 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 15 lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

JEPET PËLQIMI-për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës si më poshtë;

Parcela P-72116046-00545-7, me sipërfaqe të përgjithshme prej: $S=252m^2$, sipas certifikatës së pronës Nr. 1189-2025 të datës 12.03.2025, zona kadastrale Suharekë, vendin i quajtur "Fshat", e evidentuar në emër të Komunës së Suharekës, për ndërtimin e objektit afarist banesor, me destinim sipas Hartës zonale të Komunës së Suharekës, banim me shumë njësi ZB5.

Neni 2

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastrë, Drejtoria për urbanizëm dhe planifikim dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e konkurrimit të hapur, konform dispozitave të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019" dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-18942
Me datë 28.03.2025



Kryesuesi i Kuvendit
Mr. Bexhet KUÇI



Republika e Kosovës
Republica Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72116046-00545-7

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 1189-25
Data dhe koha e lesimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 12.03.2025 - 10:43
Komuna / Opština / Municipality: SUHAREKË / SUVA REKA / SUHAREKË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Suharekë / Suva Reka / Suharekë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: SUHAREKË / SUVA REKA / SUHAREKË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72116046-00545-7	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	252	11-463-81085/2022 / 29.12.2022	29.12.2022	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
FSHAT		MOTRA JOHANA	29.12.2022	

A.2 LLOJII I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numbri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parces Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parces Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina Area (m ²)
1	Tokë Ndërtimore/Grudhevinsko zemljište/Construction land	Trrall/Zemliste/Land		252

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Titulli i drejtimit Prava Rights	Emri i Ime Name	Nr. personal Licenci broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Pronësi individuale (Një Pronare) / Individualno Vlasništvo (1 VL) / Single Owner	Komuna e Suharekës	600535209	///		BRIGADA 123	1/1		29.12.2022



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : SUHAREKË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Suharekë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-72116046-00545-7	Parcelë / Parcela / Parcel	252



Shkalla/Razmera/Scale: 1:185



Punoi/Obradio/Created: kujtim gashi

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 12.03.2025

Koha/ Vreme/ Time: 10:44:52